

LIGJ
Nr.9872, datë 14.2.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5632, datë 25.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë *në frymën e marrëdhënieve* miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar premtimit të ambasadës gjermane në Tiranë të datës 15 dhjetor 2004 dhe konsultimeve ndërqeveritare të datës 13 mars 2007 në Tiranë,

janë marrë vesh për sa më poshtë:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW – Frankfurt mbi Main), shumat e mëposhtme:

1. hua me vlerë prej deri në 4 000 000 eurosh gjithsej (me fjalë: katër milionë euro) për projektin “Programi i furnizimit me ujë të zonave rurale”, si dhe

2. një shumë financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në pikën 1, me vlerë deri në 1 000 000 euro gjithsej (me fjalë: një milion euro). Kur nga shqyrtimi përkatës u konstatua se projekti vlen për t’u mbështetur.

2) Nëse Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bien dakord, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau

hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

4) Shumat e financimit për masa shoqëruese sipas paragrafit 1 pika 2 do të kthehen në hua në rast se nuk përdoren masa të tilla.

Neni 2

1) Përdorimi i kontributit financiar të përmendur në nenin 1, kushtet nën të cilat vihen në dispozicion, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis KfW-së dhe marrësve të huave respektive të shumave të financimit, kontrata të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2) Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1, paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 do të zhvlehtësohen në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vitesh pas vitit të premimit. Për shumat në fjalë ky afat përfundon më datë 31 dhjetor 2012.

3) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditanstalt fur Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro, duke plotësuar detyrimet e huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë marrësi i shumës së financimit, do të garantojë Kreditanstalt fur Wiederaufbau premtime eventuale lidhur me shlyerjen që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt fur Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që nuk rezulton nga dhënia e huasë dhe nga dhënia e shumës së financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, në rast se nevojiten, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Nga huaja me vlerë prej 23 500 000 DM (me fjalë: njëzet e tre milionë e pesëqind mijë marka gjermane) baraz me 12 015 359, 21 euro (me fjalë: dy milionë e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë euro dhe njëzet e një cent) e parashikuar në marrëveshjen e datës 10 maj 2001 për bashkëpunimin financiar-projekti “Mbështetje për ekonominë nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës komunale Elbasan” do të zbritet dhe riprogramohet një shumë prej 3 500 000 euro (me fjalë: tre milionë e pesëqind mijë euro). Kjo shumë do të përdoret si shtesë për projektin “Programi i furnizimit me ujë të zonave rurale”, të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 pika 1.

Neni 6

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, që janë plotësuar kushtet brenda shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është data e marrjes së njoftimit.

U firmos në Tiranë, më 28.12.2007 në dy ekzemplarë origjinalë, secili në gjuhën gjermane dhe gjuhën shqipe, të dy tekstet me të njëjtën vlerë autentike.